

BIOS

Basic Input Output System

BIOS: është një program me instruktionet më primare te gjësendet e forta në një kompjuter. Programi rri më së shpeshti i vendosur në flashmemorje. Kur një kompjuter starton, është BIOS: ai që kujdeset nëse kompjuteri starton me sukses dhe pas zbulimit të inicimeve të para ja le punën e mëtutjeshme sistemit operativ (psh. Windows 98/Me/2000/XP) nga harddisku ose disketstation.

RIPËRTËRIJE BIOS

Këtu më poshtë e kemi përshkruar se si një BIOS vendoset në flashmemorie. Procedura mund të dalloj në mes kartelave bazë, por shumica e tyre që kanë në vehte një flashmemorie, e kanë të njejtin princip.

1. Kontrolllo BIOS versionin tënd (imi është: ASUS P2B ACPI BIOS Revision 1006).
2. Shko në CMOS dhe shkruaj me "printer" STANDARD CMOS SETUP, BIOS FEATURES SETUP, CHIPSET FEATURES SETUP, POWER MANAGEMENT SETUP, PNP AND PCI SETUP.
3. Shko te webfaqja www.asus.com dhe instalo "flash-programin" AFLASH.EXE (V1.24) dhe BIOS-filetë fundit që në rastin tim ishte bx2i1011.zip (P2B BIOS Ver. 1011. 22.10.2000).
4. Shpaloje BIOS-file (bx2i1011.awd).
5. Vendose AFLASH.EXE dhe BX2I1011.AWD direkt në "C" ose "D"....varësisht se ku harddisk është i ndarë ose nëse i ke disa, që të njejtat të mund të takohen në DOS-pozitë.
6. Gjeje një disket instalimi për DOS-version i mëparshëm (Unë e kam patur DOS 6.0).
7. Krijë një startdisket në DOS. (VENI RE ! DOS-pozita nga WINDOWS nuk bën). Fute disketen e DOS-instalimit në Floppy dhe restarto kompjuterin. Pas startimit ajo e merrë nga disketa pozitën DOS dhe DOS menyja del para nesh. Por mos e instalo DOS në harddisk...veçse zgjedhe "F3" në menyen, pra përfundoje pa e instaluar DOS në kompjuter. Aty vjen në "A:\>" shkruaj "FORMAT A:/S" dhe shtype tasterin "enter". Nxjerre disketen jashtë dhe fute një tjetër, të zbrazët dhe formatizoje ate, pastaj nxjerre disketen jashtë dhe shtype "Ctrl Alt Delete" për me e restartuar kompjuterin.
8. Kopjo AFLASH.EXE dhe BX2I1011.AWD në startdisket. Kur e restarton kompjuterin prap e zgjedh start nga DOS pozita. Pas kësaj vijm në këtë DOS-pozitë "C:\WINDOWS>" nëse filet gjinden në "C" shkruaj "cd" për me ardhur në "C:\>", nëse filet gjinden në "D" shkruaj "D:". Fute startdisketen dhe shkruaj "COPY AFLASH.EXE A:" pastaj "COPY BX2I1011.AWD A:". Kur kryhet

BIOSS

kjo shkruaj "A:" dhe pas "A:\>" shkruaj "DIR" për me kontrolluar se filet eardhshme gjenden në start startdisket COMMAND.COM, AFLASH.EXE dhe BX2I1011.AWD.

9.Restarto kompjuterin me startdisket (Shtype "Ctrl Alt Delete"). Tani kompjuteri starton nga startdisketa. Eventualisht mund të vij ndonjë pyetje për rregullimin e kohës...shtype "enter" derisa "A:\>" mbahet.

10. Starto AFLASH.EXE. Pran "A:\>" shkruaj "AFLASH.EXE" dhe shtype "ENTER". Menyja për "ASUS ACPI BIOS, FLASH MEMORY WRITER V1.24" del përpara. Aty gjen shënime rreth flashmemories tënde që rrin në kartelen bazë (psh. SGS-THOMSON M29F002T që quhet i imi).

11. Zgjedhe alternativën "1", "Save Current BIOS To File". Mirë është që BIOS:i mëparshëm të mbahet edhe më tutje si rezerv në rast se ky i riu shkakton farë problemi. Pas "save:" shkruaj "a:\filename" (psh. a:\440bx-01). Kur BIOS:memorizohet kontrollo porosinë që "BIOS saved successfully" të mbahet. Shtype pastaj "Esc" që të vij te menyja prap.

12. Zgjedhe alternativën "2", "Update BIOS Including Boot Block and ESCD". Pas "Please Enter File name for NEW BIOS:" shkruaj "a:\bx2i1011.awd" dhe "enter". Tani vjen edhe një foto ku ndër të tjera flashmemorja jap të dhëna për "BIOS Versionin, BIOS Modelin, Date of BIOS Built". Këtu BIOS "CURRENT" momental mund të krahasohet me atë BIOS-file të re. Edhe porosia ipet këtu "Notice" (mua më doli " Boot Block is different. Checksum of bx2i1011.awd is 5541,gjë që është në rregull..."). Në pyetjen "Are you sure (Y/N)" shkruaj "Y" dhe shtype "enter". Tani fshihet flashmemorja dhe ajo BIOS:e reja instalohet serish. Pastaj vjen porosia: "Flashed Successfully". Veni Re ! Nëse ky operacion ju kryhet pa sukses, shkoni te BIOS:i vjetër ! Çka do që ndodhë, mos e ndalni kompjuterin derisa nuk e bënë që një BIOS të funksionojë..... nëse kompjuteri ndalet pa e krye punën e BIOSose ju ndalet rryma bash kur memorizimi i flashit ndodhë, atëherë kompjuteri nuk starton më. Nëse je aqë pafat atëherëduhet flashmemoria të demontohet nga kartela bazë dhe të programohet nga një programer ose të ndërrohet me një të ri nga i njejt prodhues.

13. Kur BIOS:është vendosur në flashmemorie shtype "Esc" për me dal nga aflash.exe. Nxjerre disketen dhe restarto kompjuterin (shtype "Ctrl Alt Delete"). Kontrolllo BIOS versionin gjatë sekvences së startimit dhe shko në i CMOS dheshiqo aty se a kanë ndodhë ndërrime. Krahaso këto të dhëna me ato ndër pikën 2.
Kaq!

Copyright © Agron Sapunxhiu
[Agroni nga Peja](#)

